Lezhë, më 28.06.2022

# PROCESVERBAL

I mbajtur sot, në dt. 28.06.2022, në orën 08:00, në sallën e Qendrës Kulturore të Fëmijëve (QKF), mbi mbledhjen e radhës të muajit Qershor 2022, e shtyrë për arsye objektive, pasi ishte caktuar për dje, në dt. 27.06.2022, në orën 13:00.

Mbledhja u hap nga zv/kryetari i K.B. Lezhës, z. Ndue Luli, i cili lexoi rendin e ditës.

Kryesuesi i mbledhjes i dha fjalën zv/Kryetarit të Bashkisë z. Ermal Pacaj.

Ermal Pacaj: Ne kemi përgatitur 2 p/vendime që kanë të bëjnë me ndryshime në buxhet, që janë gati që të premten por sekretarja e këshillit, me të drejtë mendoi që nuk plotësoheshin efektet 5-ditore, kështu që kërkojmë që këto 2 p/vendime t'i shtohen sot rendit të ditës, për arsye se dinamika e veprimit për këto projekte është në pak ditë dhe të kalojnë që të marrin formë. Faleminderit.

Kryesuesi i dha fjalën këshilltarit Agostin Marku.

Agostin Marku: Në lidhje me pikën 5 të rendit të ditës, duhet të ishin këtu të gjitha drejtoritë, por drejtoria më e rëndësishme që duhet të ishte këtu, është Drejtoria e Taksave. N.q.s nuk ka ardh kjo drejtori, ta heqim nga rendi i ditës, se pret. Në parim nuk jemi kundër asaj që tha Ermali për 2 p/vendimet shtesë, megjë janë projekte të rëndësishme, por kur janë

vendime për buxhetin, dakord se dhe sekretaria ka theksuar atë që është shpallur rendi i ditës, por të paktën aty te grupi i whatsappit t'i kishit dërguar që të njihen këshilltarët, të dimë për çfarë marrim vendim. Kjo mund të ishte bë, por jo sot. T'i fusim në rendin e ditës e ne s'kemi as materialet përpara. Faleminderit.
Kryetari i dha fjalën kryetarit të Bashkisë.
Pjërin Ndreu: Janë 2 p/vendime që kanë të bëjnë me 2 investime të fituar me projekte. Ne i bëmë marrëveshjet me delegacionin europian edhe me Bashkinë e Gjakovës. Na duhet me akordu lekët. Është Muzeu Arkeologjik dhe Shkolla e Balldrenit.
Agostin Marku: Në parim jam dakord. Çështje është që të njihemi me p/vendimet dhe e dyta kërkova Dr. e Taksave.
Pjërin Ndreu: Drejtori i Taksave ka 2 ditë që ka fillur punë, sepse ka ndryshim.
Agostin Marku: Punonjës e ka? Dikush t'na japë përgjigje për realizimin e treguesve.
Ndue Luli: Bashkë me 2 projektet vendimet që u parapritën sot, kush është dakord me rendin e ditës?
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë, përveç z. Agostin Marku që nuk votoi.
Atëherë, fillojmë me pikën e parë të rendit të

ditës për këtë projekt vendim "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën 01-31 Maj 2022".

Kush është dakord?

Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.

Kalojmë te pika 2 për këtë projekt vendim "Për një shtesë në vendimin nr. 3, dt. 01.02.2022 "Për miratimin e listës së të pastrehëve që përfitojnë subvencionim të qirasë për vitin 2022""

Kryesuesi i dha fjalën specialistes së Drejtorisë së Shërbimit Social e cila dha shpjegime sipas relacionit përkatës.

Ndue Luli: E kalojmë në votim.

Kush është dakord?

Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.

Kalojmë te pika 3 për këtë projekt vendim "Për Komisionimin e të miturit me iniciale P.L. në Qendrën Rezidenciale Kolo Akutis".

Meqë nuk ka diskutime, e hedhim në votim.

Kush është dakord?

Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë, përveç z. Agostin Marku që nuk votoi.

Kalojmë te pika 4 për këtë projekt vendim "Për një ndryshim në VKB nr. 177, dt. 23.12.2021 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2022 dhe PBA-së 2022-2024""

Kryesuesi i dha fjalën drejtorisë së Financës, e cila dha shpjegime sipas relacionit përkatës.
Agostin Marku: Në relacion shkruhet, në p/v jo.
Hipen nga ky objekt, shkohen në këtë objekt.
Ndue Luli: E hedhim p/v në votim.
Kush është dakord?
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezent, përveç z. Agostin Marku që nuk votoi.
Kalojmë te pika 5, që është projekt vendim "Për miratimin e buxhetit faktik për 4-mujorin e parë të vitit 2022"
Kryesuesi i dha fjalën drejtorisë së Financës, e cila dha shpjegime sipas relacionit përkatës.
Kryesuesi i dha fjalën këshilltarit Agostin Marku.
Agostin Marku: Së pari, këtu shihet dukshëm se nuk janë realizuar treguesit e taksave, që ka të bëjë ose me mosfunksionimin e Paketës Fiskale, ose me paaftësinë e administratës tatimore. Nuk është problemi që nuk është realizuar një e ardhur për arsye objektive, se për arsye subjektive mund të përmendim taksën e ndikimit në infrastrukturë. Këtu vetëm një gjë është e mirë, sepse është mbajtur nën kontroll çështje e likuiditetit, sepse shpenzimet janë më të ulta se të ardhurat, megjithëse janë të lidhura me mosrealizim. Kjo është gjë e mirë sepse nuk e lë bashkinë që të falimentojë. Dihet për të gjitha bashkitë, jo vetëm për Bashkinë e Lezhës,

kur nuk realizohen të ardhurat, pjesë e mosrealizimit,
bie direkt mbi investimet. Unë ndoj i dojë sot
edhe specialistët e D. së Taksave që të na japin
përgjigje për çështje teknike. Po marr treguesin
e taksës së fjetjes në hotel, që juve mund t'ju
duket diçka elementare. Bashkia Lezhë, për sa
i përket resurseve turistike hyn në 4-5 bashkitë
më të privilegjuara sepse kemi bregdetin. Ne
gjithë ditën propagandojmë për turizëm, por se
vjelim ne nga ky turizëm. Unë, psh, dojë të dijë
se është kapaciteti i shtretërve në Shëngjin dhe
Tale, po e lëmë pjesën tjetër, ku na mbytën
hotelet. Ne e kemi të vërtetuar se të paktën
prej një viti, në Lezhë flenë vetëm 2000 afganë.
Ato flenë në një resort. Ky resort paguhet nga
qeveria, nga OKB-ja. Pak rëndësi ka.
2000 veta që flenë aty nga 25 lekë që e
kemi taksën e fjetjes në hotel për person,
do të thotë 2,5 mln lekë të vjetra në ditë.
Ku janë? A e dini se e kemi vjeljen e taksës
së fjetjes në hotel? 978 000 lekë të reja.
Kështu e kemi raportuar ju. Atëhërë, këtu
a kemi të bëjmë me evazion fiskal, kemi të
bëjmë me paaftësi të administratës tatimore
të bashkisë? Po i drejtohem kryetarit të
Bashkisë. Je në kohë për ta korrigjuar, të
paktën periudhën e mbetur. Nuk me do

mendje se është keq që mund të thotë që në Shëngjin nuk flenë 10000 pushues në natë gjatë periudhës së verës. A e dini se del Shuma? Mund të shkojë deri në 1 mln €. Por me 1 mln € bën nomin, bashkia me investime, me shlyerje detyrimesh etj. Me ça merret administrata tatimore? Unë nuk i njoh, nuk kam problem me asnjërin.

Unë do ju dorëzoj sot një kërkesë, pikërisht për këto probleme që thashë, unë i kërkoj këshillit të Bashkisë që ta fusë në rendin e ditës në mbledhjen e ardhshme

Pjerin Ndreu: Në argument je komplet korrekt. Problemi, që të jem i pertë, është i administratës tatimore, që nuk ka funksionuar. Ne kemi bërë një analizë para disa kohësh, duke parë parasysh edhe mosnjohjen tonë, administrata tatimore është një çorap sepse akoma punojnë në mënyrë manuale. Ne kemi marrë masa të menjëhershme tani. E para ka lëvizur drejtuesi, e dyta, jemi duke bërë një sistem të marrjes së të dhënave, ku hyn edhe kontrolli i dhomave hotel për hotel, kemi nxjerrë për prokurim sistemin dixhital tonin. Të vjelim taksat. Sepse edhe efati ka pjesën e vet. Kemi 1 muaj që e kemi shtyrë efatin. Po rishikohen edhe një herë faturat sepse diku janë bërë në

mënyrë arbitrare, dikujt nuk ia kanë dërguar
farë. Janë plotësisht dakord, që ato janë të
ardhura të munguara. Pretendojmë që këtë vit
dhe vitin tjetër ta vëmë nën kontroll. Përmirësim
do ketë edhe ~~që~~ prej riorganizimit të administratës
tatimore por edhe prej sistemit dixhital.
Jo vetëm për taksat, por për të gjitha
shërbimet e bashkisë që do jenë online.
Kemi 3 vjet që ne nuk kemi realizuar dot
njëfishimin e abonentëve familjarë
Kemi bërë gati ekipet që duhet të shkohet
sondazh në hotele
Ndue Luli: Atëherë, kush është dakord me pv?
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë,
për z Agostin Marku që nuk votoi.
Duke u nisur nga disa arsye objektive që
kanë 2 këshilltarë, për largim, pak më vonë,
jo tani, mendojmë të kalojmë te pika 9 e
rendit të ditës, pasi është me shumicë të
cilësuar dhe është projekt-vendim "Për miratimin
në parim të vënies në dispozicion të pasurive, fondit
të pasurive të paluajtshme për mbështetjen e
investimeve strategjike, Ministrisë së Financave
dhe Ekonomisë". Ky, në fakt, është një pv
që është diskutuar nga ne dhe në mbledhjen
e kaluar, por për mungesë kuorumi ka
kaluar në këtë mbledhje. Është bërë një

diskutim i madh në mbledhjen e kaluar, megjithatë po pati e rikalojmë prapë, përndryshe e kalojmë në votim.

→ Doli këshilltari Mark Gjon Lushaj.

Ndue Luli: Meqë nuk ka diskutim, e kalojmë projekt-vendimin në votim.

Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë, përveç z. Apostin Marku që nuk votoi.

Kalojmë te pika 10 e rendit të ditës që është projekt-vendim "Për miratimin e listës së përdoruesve faktikë të tokës bujqësore". Kush ka diçka? Edhe ky është me shumicë 3/5.

Apostin Marku: Në parim jam dakord. Mendoj që duhet të mblidhen të gjitha rastet dhe t'i kalojmë në bllok. Mos të bëjmë vendim pas vendimi. Ndihmojmë pyetësorët. Tokën ua jep në pronësi, pastaj të lind e drejta të kërkosh taksë për këtë tokë. Njësitë Administrative të merren më këtë problem, t'i evidentojnë.

Pjerin Ndreu: Ne tani kemi organizuar Drejtorinë e Kadastrës për këtë problem. Janë bashkuar aty sektori i Kadastrës dhe sektori i aseteve.

Ndue Luli: Kush është dakord?

Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.

Kalojmë te pika 11 e rendit që është projekt vendim "Për përfundimin e procedurave të miratizimit të banesave, të cilat kanë

mbetur pa u regjistruar në ASHK".
Edhe ky p/v kërkon shumicë të cilësuar.
Agostin Marku: E kalojmë.
Ndue Luli: kush është dakord?
Miratohet një të gjithë këshilltarët prezent, përveç z. Agostin Marku që nuk votoi.
Tani rikthehemi, vazhdojmë me pikën 6 të rendit të ditës që është projekt vendim "Për miratimin e PBA-së 2023-2025 të Bashkisë Lezhë (Faza e Parë)".
- kërkoi fjalën z. Agostin Marku i cili tha se disa investime për vitet 2024, 2025 por edhe 2023 janë lënë pa fond, për të cilën e shoh pa vend.
Ndue Luli: Në lidhje me këtë p/vendim, Kryesia e këshillit ka organizuar në dt 16 qershor, këtu në sallën e QKF-së, një takim me komunitetin dhe me këshilltarët për të diskutuar rreth tij. Për mungesë përjesëmarrje, dështoi, si shumë raste të tjera që kanë ardhur si rezultat i mos organizimit që duhet të kemi jo vetëm ne si këshilltarë por edhe komuniteti, për t'u interesuar për projekt buxhetin e bashkisë.
Rigels Nicaj: More mundimin me ba një kërkesë. Kam ndenjur 30 minuta duke u sjellë se nuk dija ku me e dorëzu. Neve duhet të na

merren në konsideratë kërkeset, që ne të jemi pjesë e këtyre programeve, sepse kush më mirë se ne i mbron, i publikon, i propagandon

Ndue Luli: Kopjen e shkresës tënde e kam në dorë tani.

Pjetrin Ndreu: këto fjalë janë pak si helmuese. Je këshilltar, ke të drejtën e propozimit tënd direkt të gjithëkujt. Thjesht e protokollon shkresën. S'ka me të gjetë kush vëndallë nëpër bashki.

Ndue Luli: Për projekt vendimin në pikën 6 të rendit të ditës kush është dakord?
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë përveç z. Apostin Meksi që nuk votoi.
Kalojmë te pika 7 e rendit të ditës që është projekt vendim "Për miratimin e marrëveshjes së partneritetit të Bashkisë Lezhë me Komunën e Gjakovës dhe Creative Business Solutions (CBS) për zbatimin e projektit "Ndërlidhja e turizmit përmes trashëgimisë kulturore dhe zgjidhjeve inteligjente në Lezhë dhe Gjakovë".
Meqë nuk ka diskutime e kalojmë në votim.
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë përveç z. Apostin Meksi që nuk votoi.
Kalojmë te pika 8 e rendit të ditës që është projekt vendim "Për ndryshimin e

emërtimit të rrugës m. 03160026, nga "Bërzane" në "Bërzane e Re"."
Kush është dakord?
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezent, përveç z. Agostin Marku që nuk votoi.
→ Doli këshilltarja Greta Marku
Ndue Luli: Kalojmë te pika 12 e rendit të ditës që është projekt-vendim "Për ndryshimin e emërtimit të rrugës m. 03140075, nga "Pyjore" në "Gjon Dode Marku""
Agostin Marku: Urrej jam shumë dakord. Kam marrë vetëm fjalë shumë të mira për të ndjerin por si po sens kjo. Na e propozon një shkopatë në Shkodër. Pse s'e propozon Bashkia vetë, apo këto shkopatet e Mirditës që i kena me bollek. Banorët mund te respektojnë shumë atë por merret edhe mendimi.
Ndue Luli: Ishte dhe gabimi im se nuk e theksë që në fillim, sepse një grup këshilltarësh i kryesuar nga Kryetari i këshillit ka bërë konsultim publik lidhur me të, është bërë takim në lagje.
Agostin Marku: Është dhe një rast që ka kohë që është depozituar kërkesë, për një emër rrugë në Kalorinj dhe akoma nuk është bërë. Po bëjeni. Ka qenë një plak i urtë, një plak i mirë ai.

Pjerin Ndreu: Çdo propozim që ka ardhur nga komuniteti, ne e kemi sjellë në këshill.
Ju si këshilltarë komunikoni me njerëzit sipas zonave, nxitini që t'i sjellin propozimet se është më mirë që emërtimet e rrugëve të bëhen me propozim nga poshtë.
Ndue Lulë: Kush është dakord?
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë, përveç z. Agostin Marku që nuk votoi.
Kalojmë te pika 13 e rendit të ditës që është projekt-vendim "Për miratimin e ndihmës financiare për z. E. Ll. nga fondi i emergjencës".
Meqë nuk ka diskutim, e kalojmë në votim.
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë, përveç z. Agostin Marku që nuk votoi.
Kalojmë te pika 14 e rendit të ditës që është projekt-vendim "Për lidhjen e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet programit për zhvillim të Kombeve të Bashkuara dhe Bashkisë Lezhë për zbatimin e projektit "Forcimi i kapaciteteve të shërbimit shqiptar të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin" (FKSHSHMZSH)
Meqë nuk ka diskutime, e kalojmë në votim.
Kush është dakord?
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë përveç z. Agostin Marku që nuk votoi.
Kalojmë te pika 15 e rendit të ditës që është

projekt-vendim "Për përdorimin e metodologjisë
LOA për alokimin e fondeve për organizatat e
shoqërisë civile për fondin e miratuar për sportin,
disiplina futboll me VKB nr. 58, dt. 13.06.2022".
Meqë nuk ka diskutime, e kalojmë në votim.
Kush është dakord?
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë,
përveç z. Agostin Markun që nuk votoi.
Kalojmë te dy projekt-vendimet e fundit të
cilat i miratuam t'i fusim në rendin e ditës.
Atëherë, projekt-vendim "Për një ndryshim në
VKB nr. 177, dt. 23.12.2021 "Për miratimin
e buxhetit të vitit 2022 dhe PBA-së 2022-2024""
që ka të bëjë me ndërtimin e Muzeut
Arkeologjik Mesjetar në Lezhë!
Kush është dakord?
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.
Projekt-vendimi i fundit është "Për një ndryshim
në VKB nr. 177, dt. 23.12.2021 "Për miratimin
e buxhetit të vitit 2022 dhe PBA-së 2022-2024"".
që ka të bëjë me likuidim detyrimesh me
vendime gjykate.
Kush është dakord?
Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.
Atëherë kalojmë te pika "Të ndryshme".
z. Agostin Marku paraqiti kërkesë me shkrim
drejtuar Kryetarit të Bashkisë dhe Këshillit

Boshnjak dhe kërkoi nga Kryesia e Këshillit që të futet në rendin e ditës të mbledhjes së ardhshme të radhës.

Z. Ndue Luli ngriti shqetësimin e Komunitetit për kopshtin Ungrej - Kolivoq. Fëmijët e Kolivoqit shkojnë në Ungrej, ku në Kolivoq ka 13 fëmijë, ndërsa në Ungrej ka zero fëmijë, prandaj ku ka më shumë fëmijë të ketë dhe kopsht.

Z. Gjin Kola ngriti shqetësimin lidhur me urën pranë varrezave dhe zgjerimin e varrezave të Ungrejve dhe Frepën që nuk ka vend më.

Z. Rigels Nicaj ngriti shqetësimin e [illegible] të lëvizjes në Shëngjin, dhe që Policia Bashkiake nuk e ka mbështetjen e Policisë së Shtetit.

Për shqetësimet e ngritura, këshilltarët morën sqarime nga Kryetari i Bashkisë z. Pjerin Ndreu.

ZV/Kryetari deklaroi mbledhjen të mbyllur.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

ZV/KRYETARI
NDUE LULI